

Emri i Lëndës : Multimedia							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
IMC 301	B	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori		Alban Tufa, Msc					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Program Profesional 2-Vjeçar					
Përshkrimi		Në këtë kurs studentët do të prezantohen me parimet dhe teknologjitë aktuale të sistemeve të kombinuara, tekstit, grafikës, tingullit, animacionit dhe videos. Gjithashtu studentët do të mësojnë sesi të zhvillojnë programe të ndryshme multimediale. Një tjetër objektivi është të mësojnë sesi mund të digjitalizohen imazhet, tingujt dhe videot nëpërmjet programeve të ndryshme. Studentët, përveç njohurive teorike rreth aplikacioneve multimedias, do të angazhohen në projekte individuale dhe në grup për t’ë për të përvetësuar teknikat më të fundit.					
Objektivat		1. Dhënia e njohurive të nevojshme fundamentale për multimedian. 2. Shpjegimi i koncepteve dhe pajisja e studentëve me aftësi për aplikimin e këtyre koncepteve në praktikë. 3. Aftësimi i studentëve për konceptimin dhe realizimin e një projekti multimedial. 4. Pajisja me njohuri mbi rolin që ka sot multimedia në epokën e zhvillimit teknologjik, për t'i përdorur këto njohuri në media, PR, sektorin e reklamave, etj.					
Konceptet Kryesore		1. Multimedia 2. Tekst 3. Zë 4. Imazh 5. Përmbajtje 6. Video 7. Editim 8. Rrëfim multimedial					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Prezantimi i lëndës Në këtë javë studentët njihen me sylabusin, diskutohen temat që do të përmbajë i gjithë kursi, zërat e vlerësimit, duke përfshirë testimet, projektet. Po ashtu gjatë këtij leksioni, studentët njihen me literaturën bazë, atë mbështetëse, mjetet e punës që nevojiten gjatë kursit, si edhe programet e domosdoshme për në vazhdim.						
2	Hyrja në multimedia, bazat dhe konceptet themelore. Teoria e Multimedias. Në këtë leksion studentët njihen me multimedian si koncept dhe domethënien e saj, elementët e saj përbërës, historinë e shkurtër të multimedias, dallim mes koncepteve “Media” “Old Media” “New Media” “Digital Media” dhe “Hipermedia”, llojet e pajisjeve multimediale, multimedia dhe interneti. Po ashtu përgjatë këtij leksioni trajtohen paltformat e multimediale dhe aplikimi i multimedias në jetën e përditshme të tilla si: Video On Demand; Video Streaming; Multimedia Mail; Multimedia Conferencing; Interactive TV; Media editors; Social media dh e Mobile Media. “Fundamentals of Multimedia”, Ze-Nian Li; Mark S. Drew; Jiangchuan Liu, Springer 2014, Botimi i dytë, Switzerland, faqe 3-16 “Elements of Multimedia”, Sreeparna Banerjee CRC Pres 2019, New York, faqe 1-15 “Multimedia Foundations: Core Concepts for Digital Design”, Vic Costello, 2024, Routledge, fq 2-32						

3	Aplikacionet dhe programet multimediale, parimet dhe elementët e dizajnit multimedial. Përgjatë këtij leksioni studentët do të njihen me llojet e programeve multimediale duke filluar me programet me bazë interneti (online), dhe duke kaluar më tej te programet pa internet (offline). Leksioni do të trajtojë tiparet e secilit lloj programi, mënyrat punimit dhe parimet e tyre kryesore. Përsa iu përket programeve online në trajtim do të merren CANVA; CHLIPCHAMP dhe CRELLO, ndërsa në ato offline do të merret në trajtim paketa Adobe dhe Filmora Wondeshare. Në përfundim të leksionit studentët do të trajtojnë aspektet e krijimit multimedial; prezantimit multimedial, produktin multimedial; si dhe shpërndarjen multimediale, duke marrë në konsideratë formatet e përshtatshme e për t'u ndarë në mediumet multiplatformëshe. "Fundamentals of Multimedia", Ze-Nian Li; Mark S. Drew; Jiangchuan Liu, Springer 2014, Botimi i dytë, Switzerland, faqe 16-25 "Elements of Multimedia", Sreeparna Banerjee CRC Pres 2019, New York, faqe 15-23 "Multimedia Foundations: Core Concepts for Digital Design", Vic Costello, 2024, Routledge, fq 2-32
4	Teksti në multimedia. Parimet themelore. Leksioni trajton rëndësinë që ka teksti në produktet multimediale, llojet e tekstit, fontet, elementët përbërës në tekst, formatet dhe grafikat tekstuale. Më tej leksioni analizon aspektet e Dizajnit të tekstit; mënyrat për të përfaqësuar tekstin, mënyrat efektive për përdorimin e tekstit, avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të tekstit, enkriptimi dhe dekriptimi, emocionet dhe emoji, teksti në pajisjet mobile. Në fund renditen dhe trajtohen formatet e ruajtjes së tekstit. "Multimedia Foundations: Core Concepts for Digital Design", Vic Costello, 2024, Routledge, fq 158-186 "Elements of Multimedia", Sreeparna Banerjee CRC Pres 2019, New York, faqe 25-37
5	Konceptet dhe parimet themelore të audios. Audio-ja digjitale dhe ndërfaqet e zërit. Në këtë leksion do të trajtohen konceptet themelore të zërit: amplituda; frekuenca; mbështjellja; karakteristikat e zërit, digjitalizimi i zërit, koncepti i MIDI-t, kodet e zërit, filtrimi i audios, cilësia e zërit dhe data rate, pajisjet e regjistrimit, ndërfaqet e zërit dhe pajisjet që luajnë muzikë. Po ashtu, leksioni trajton në fund edhe formatet e audios. "Multimedia Foundations: Core Concepts for Digital Design", Vic Costello, 2024, Routledge, fq 291-322 "Elements of Multimedia", Sreeparna Banerjee CRC Pres 2019, New York, faqe 39-66 Fundamentals of Multimedia", Ze-Nian Li; Mark S. Drew; Jiangchuan Liu, Springer 2014, Botimi i dytë, Switzerland, faqe 140-176
6	Prezantimi me të dhënat e grafikës dhe të imazhit. Imazhi në Multimedia Përgjatë këtij leksioni do të analizohen parimet e imazhit; llojet e imazhit: imazhet bitmap dhe imazhet grafika vektoriale; imazhet 1 bit; 8 bit dhe 24 bit; pikselat dhe llojet e imazheve. Po ashtu në këtë leksion do të trajtohen formatet më popullore të ruajtjes së imazhit (JPEG, GIF, PNG, TIFF, PDF, etj); ngjyra dhe rëndësia e saj në imazhe. Dallimet mes fotografisë artistike dhe fotografisë për reklamë. Po ashtu leksioni trajton llojet dhe formatet e imazheve në pajisjet e lëvizshme. "Fundamentals of Multimedia", Ze-Nian Li; Mark S. Drew; Jiangchuan Liu, Springer 2014, Botimi i dytë, Switzerland, faqe 53 - 100 "Elements of Multimedia", Sreeparna Banerjee CRC Pres 2019, New York, faqe 67-79
7	Konceptet dhe parimet themelore të videos. Videoja digjitale dhe ndërfaqet e ekraneve Në këtë leksion studentët do të njihen me konceptet themelore të videos; ngjyrat e videos; llojet e sinjaleve video; videoja analoge dhe videoja digjitale; formatet e regjistrimit; llojet e videos digjitale, pajisjet e regjistrimit dhe pajisjet elektronike me ekran. Po ashtu gjatë leksionit studentët do të trajtojnë koncepte dhe formate që lidhen me videon dhe televizionin si dhe videon në pajisjet celulare. "Multimedia Foundations: Core Concepts for Digital Design", Vic Costello, 2024, Routledge, fq 223-264 Fundamentals of Multimedia", Ze-Nian Li; Mark S. Drew; Jiangchuan Liu, Springer 2014, Botimi i dytë, Switzerland, faqe 115-137 "Elements of Multimedia", Sreeparna Banerjee CRC Pres 2019, New York, faqe 81-91
8	Provimi gjysmefinal
9	Multimedia, animacioni dhe grafika kompjuterike "Leksioni ofron një hyrje gjithëpërfshirëse në fushën e animacionit, duke filluar me konceptet themelore dhe specifikimet kryesore të animacionit. Ai eksploron marrëdhëniet midis ekraneve dhe animacionit, duke theksuar mënyrat në të cilat animacioni përmirëson përvojat dixhitale. Studentët do të fitojnë njohuri për më të përdorurat Mjetet dhe teknikat e animacionit, si dhe tendencat në zhvillim, si realiteti virtual. Kursi trajton dizajnin e personazheve, grafikën e lëvizjes dhe efektet vizuale, ndërsa mbulon edhe bazat e grafikës kompjuterike të kuptuarit e aplikimeve të ndryshme të disiplinës." "Elements of Multimedia", Sreeparna Banerjee CRC Pres 2019, New York, faqe 93-104

10	Ruajtja e produkteve multimediale. Magazinimi multimedial është një shqetësim i rëndësishëm në zhvillimin e produkteve multimediale sepse kërkohet një sasi e madhe e ruajtjes për shkak të pranisë së mediave transmetuese si audio dhe video, përveç mediave statike. Edhe mediat statike si imazhet konsumojnë një sasi të konsiderueshme të hapësirës së kujtesës. Ekzistojnë dy aspekte të ruajtjes, përkatësisht, pajisjet për ruajtje, si dhe ruajtja e të dhënave në bazat e të dhënave. Pjesa e parë e këtij leksioni diskuton pajisjet e ruajtjes. Pjesa e fundit dytë e leksionit përshkruan marrjen e përmbajtjes nga bazat e të dhënave, me referencë të veçantë për imazhet “Multimedia Foundations: Core Concepts for Digital Design”, Vic Costello, 2024, Routledge, fq 33-62 “Elements of Multimedia”, Sreeparna Banerjee CRC Pres 2019, New York, faqe 149-162
11	Krijimi i produkteve multimediale Leksioni trajton nmetodat e ndryshme për krijimin e produkteve multimediale, duke ofruar një eksplorim të detajuar të modelit ADDIE dhe rolin e tij në drejtimin e procesit të projektimit. Ai zbërthen fazat e ndryshme të dizajnit multimedial, nga konceptimi deri te zbatimi, duke adresuar gjithashtu parimet Elementet kryesore të prezantimit multimedial, të tilla si stilet grafike, parimet e ngjyrave dhe përzgjedhja e shkronjave, diskutohen për të përmirësuar komunikimin vizual. “Multimedia Foundations: Core Concepts for Digital Design”, Vic Costello, 2024, Routledge, fq 63-91 “Elements of Multimedia”, Sreeparna Banerjee CRC Pres 2019, New York, faqe 133-147
12	Storytelling në argëtim Në këtë leksion trajtohet rëndësia që ka rrëfimi i historive argëtuese në komunikimin multimedial, të tilla si filmat artistik të llojeve dhe metrazheve të ndryshme, rrëfimi i historive të tjera të shkurtra. Po ashtu, leksioni trajton mënyrat se si këto modele të të komunikuarit me audiencat ndërtohen, tiparet dhe parimet kryesore të tyre. Në trajtesë merren fotot artistike, videoartet e ndryshme, videoklipet, booktrajler, dhe elementet thelbësorë që përbëjnë ato. Multimedia Storytelling for Digital Communicators in a Multiplatform World”, Seth Gitner, Routledge 2023, New York, faqe 227-376
13	Storytelling në komunikim strategjik Në këtë leksion do të trajtohen aspektet teorike të narracionit me imazhe në qasjen e komunikimit strategjik (reklamë). Përgjatë leksionit do të trajtohen aspektet e rëndësishme multimediale të rrëfimit mbi një organizatë, përcimin e një ideje, komunikimin e një produkti apo shërbimi, etj. Më tej, do të trajtohet rëndësia e rrëfimit multimedial në komunikimin strategjik, ose ndërtimi i reklamës multimediale. Multimedia Storytelling for Digital Communicators in a Multiplatform World”, Seth Gitner, Routledge 2023, New York, faqe 227-376
14	Storytelling në komunikim strategjik Në këtë leksion do të trajtohen aspektet teorike të narracionit me imazhe në qasjen e komunikimit strategjik (reklamë). Përgjatë leksionit do të trajtohen aspektet e rëndësishme multimediale të rrëfimit mbi një organizatë, përcimin e një ideje, komunikimin e një produkti apo shërbimi, etj. Më tej, do të trajtohet rëndësia e rrëfimit multimedial në komunikimin strategjik, ose ndërtimi i reklamës multimediale. Multimedia Storytelling for Digital Communicators in a Multiplatform World”, Seth Gitner, Routledge 2016, New York, faqe 227-376
15	Prezantimi i projekteve finale
16	Provim Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• “Multimedia Foundations: Core Concepts for Digital Design”, Vic Costello, 2024, Routledge, New York • “Fundamentals of Multimedia”, Ze-Nian Li; Mark S. Drew; Jiangchuan Liu, Springer 2014, Botimi i dytë, Switzerland • “Elements of Multimedia”, Sreeparna Banerjee CRC Pres 2019, New York • “Multimedia Storytelling for Digital Communicators in a Multiplatform World”, Seth Gitner, Routledge 2023, New York
Referenca të tjera	• “Multimedia Storytelling for Digital Communicators in a Multiplatform World”, Seth Gitner, Routledge 2016, New York • “Multimedia: Making It Work”, Tay Vaughan, Mc Graw Hill 2011, London • “Digital Communication Communication, Multimedia, Security” Meinel, Christoph; Sack, Harald, Springer 2014, New York • “The power of visual Storytelling” Ecaterina Walter & Jessica Gioglio, Mc Graw Hill 2014 • “Audio production worktext: Concepts, Techniques, and Equipment”, Sael Sauls; Craig A. Stark, Routledge, 2019, New York • “Mobile and Social Media Journalism: A Practical Guide for Multimedia Journalism 2nd Edition”, Anthony Adornato, Routledge 2021, New York • “Feature and Narrative Storytelling for Multimedia Journalists”, Duy Linh Tu, Routledge 2015, New York • “Strategic writing: Multimedia Writing for Public Relation, Advertising and More”, Angie Hendershot, Lisa Leowen, Charles Marsh, David W. Guth, and Bonnie Poovey Short, Routledge 2024, Sixth edition, New York • “Popular Music and Multimedia”, Edited by Julie McQuinn, Routledge 2024, Third edition, New York • “Film and Television Analysis: An introduction to Methods, Theories, and Approaches, Routledge 2024, Second edition, New York • https://www.tutorialspoint.com/multimedia/index.htm • DEFINING MULTIMEDIA JOURNALISM: A SYSTEMATIC LITERATURE REVIEW, Alban Tufa & Erlis Çela, BEDER JOURNAL OF HUMANITIES, 2 (18), faqet 39-60
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të jenë në gjendje të identifikojnë parimet e produkteve multimediale.
2	Të dallojnë karakteristikat e produkteve multimediale dhe të ekzutojnë projektet.
3	Të analizojnë në mënyrë kritike projektet personale dhe punën e të tjerëve
4	Të demonstrojnë aftësitë themelore të medias.
5	Të krijojnë produksione multimediale të sakta dhe tërheqëse.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	20	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrare	1	30	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			60
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			40
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	5	70
Detyra	1	3	3
Gjysmë finale	1	2	2
Provimi final	1	2	2
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			125
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.00
ECTS			5.00